

*Syrija Minarolla*

ERDHEN  
DALLANDYSHET...

TIRANË, 1958

SYRJA MINAROLLI

23437

13625

BIBLIOTEKA E SHTETËRË  
TIRANE DALLANDYSHET

# Erdhén dallandyshet

Vosqit e vërtë mëllorat mëtuh  
mëdhenj tashmë vërtet,  
nëpër qytetin e vjetër përfsh  
ni pëllët kësaj përfshirje.

Përfshirja e Kosovës  
në luqjet e përmendur,  
qëndrën kac, nras zëdhënja dëshir,  
Folëse e së përmendur.

Sëmundja folëse shkoi korallja,  
vëllai i cili ballorëtta,  
nëpërtë vërtë po lëtja vërtet  
qëndra e ngjali vërtet.

Në mënd e radoj vërtet  
ngjali, o radoj fute —  
dëgjimi i tij i fortë  
dëgjimi i tij i fortë.

Mësuesitë dëgjimët e fortë  
dëgjimët e fortë.

NDERMARRJA SHTETËRORE E BOTIMEVE  
TIRANË, 1958.

КЛЮЧАНИИ АСУЗ

Ісламский альбом

Redaktor: LL. SILIQI

Tirazhi: 1.000

Stash: 2204-55

Shtypur në Stabilimentin «MIHAL DURI» —

## NË VEND TË PARATHËNIES

---

### ERDHËN DALLANDYSHET

Ç'kundërmon në katër anët  
era trëndelinë,  
tërë gës e cicërrime  
dallandyshet vinë.

Venë e vinë rrëth e rrotull  
duke ligjëruar,  
ngjiten qiellet, ndehen fushës  
si për t'u pushtuar.

Fluturuan te kasollja  
ku kaq vjete qenë;

ç'është kjo, mos shohin èndërr?  
Folenë s'e gjenë!

Shkoifoleja, shkoi kasollja,  
shkoi dhe baltovina,  
këtë vit në këto vende  
ç'na u ngrit uzina!

E tashi te kjo uzinë  
ngritn', o një folé,—  
ma gëzofshi moj ngaherë  
shtëpizën e re!

Mirseardhët, dallandyshë,  
me pranverën sot!  
Shend e verë e krahë-hapur  
ju presim ngamot!

## NJË YLL

I thanë t'im gjyshi t'i falshe profetit.  
U lut ai i gjori sa ditën dhe natën,  
po hallet dhe brengat s'iu hoqën të shkretit,  
dhe djersën dhe gjakun e shkru për kafshatën!

Uria, kërbaçi t'im atë ma çuan  
ndër dhera të huaj që koskat t'i lerë.  
Luftoi varfanjaku, — të tjerët fituan!  
Për të qiell' i kaltër u nxi, u bë sterrë!

Më thanë dhe mua të mbroja vatanë  
nga hasmi i tërbuar me armë e taborre.  
I lashë fëmijët dhe gruan mënjanë,  
rrëmbeva sépat' e hanxhar e kosore!

Kuçedrën e shkula, e hodha në det,  
ashtu si të parët Atdhenë e çlirova,  
po vojtjen, urinë, pastaj dhe një mbret,  
me gjakun që derdha këto veç fitova...

I thanë t'im biri: Ti ngreu për liri,  
merr pushkë a sépatë dhe malit pérpjjetë!  
Fashizmin, tiranin ta bësh pluh'r e hi,—  
me ty ësht' Lenini, vëllezërit sovjetë!

Dhe i urët, i zbatohur ndër male u ngjit,  
me vdekjen në sy luftoi për lirinë.  
Në qindra beteja një yll veç i ndrit,  
në qindra fitore si prijs ka Leninë!

## SI ATA

Te lëndin' e luleve  
se ç'më qenke shtruuar,  
librin ti mes doçkave  
mbake përqafuar.

Vogëlush syshkruari  
rri lexon ngadale  
luftënë që bënë  
shokët nëpër male.

Le të mbushet zemëra  
plot me krenari.

Po, prej atij gjaku  
je, o bir, dhe ti!

Librin le mënjanë,  
ngre sytë e vështron....  
Ç'sheh ti tutje, maleve?  
Thuaj ç'endërron?..

Mos iushmang ti endrrave,  
endërrro, vëlla!

Le të ndez' dëshira  
të jesh si ata!

Te ati luajt, luajt,

Atalv spaq gëqipas degjida

I pildi n'dëshirat, se mëdha fëm

Shap fëmduam, mëdha fëmduam

Atalv idhën, jashiq, iku iku iku

Shap fëmduam, mëdha fëmduam

## VARFËRI E SHKRETE...

Varfëri e shkretë në kurbet të çoi,  
t'i sillje shtëpisë zeher e kafshatë...  
Bir, ku m'i le koskat, bir, kush të mbuloï,  
kur si flet' e vjeshtës re në pyll të thatë?

Si e le të shkretë nënën e shtëpinë,  
Si ta duroi zemra mallin për vatanë?  
Aqë vjet sa rrojte, aqë vjet t'u nxinë,  
dritë e djell njëherë sytë e tu nuk panë!

Vendin tonë, e mjera, e kish zullumqari.  
Ç't'i bëj zemrës, djalë, dhëmbjen si ta shuaj....  
O kurbet i shkretë, më të rëntë zjarri,  
që na humbe djemtë larg në dhe të huaj!

## SOT KAM VATAN

Jam zot i tokës, jam një fshatar,  
që gaz e djell s'pash' kurrë,  
që mora pushkën dhe hapa zjarr  
dhe skllavërinë, që më dha varr,  
e bëra shkrumb e zhurë.

Më shtypi beu për kaqë vjetë,  
më thirri: — Dreq, m'u hiq!  
Më mori tokën, më mori qetë,  
pastaj më lidhi si deshi vetë  
dhe dinte se më vdiq...

Por kur një ditë zëri i kushtrimit  
buçiti anembanë,  
në ballë e vura yll' e çlirimët,  
në krah e hodha pushkën e trimit  
me shokët partizanë.

Në brez un' kisha një ball fishekë,  
në zemër kisha zjarr,  
në qafë torbën me bukë e qepë  
iu ngjita malit gjer lart në retë,  
Dhe hasmit i çel varr!

Për her' të parë ndjej lumturinë,  
sot kam vatan, o shokë!  
Kasollen shemba, ngrita shtëpinë,  
besën e dhashë: me prijs Partinë  
kopësht ta bëj kët tokë!

### DASHURIA E VERTETE

Më rrëmbeu kjo burbuqe,  
Shtat' i hedhur si selvi,  
Të dy faqet lulukuqe,  
Buzët gjak, dhëmbët inxhi...  
Po, kështu nis dashurija;  
Kështu nis, välla, kështu;  
Erdhi vjeshta, ik freskija  
Dhe ky fill mbaron këtu!

Më rrëmbeu syr'i shkruar,  
Syr' i zi, vetull— kurorë,  
Që ze djeg në krahuar,  
Që ndez zemrën zjarr e horë....  
Po, kështu nis dashurija,  
Kështu nis, vëlla, kështu:  
Ndizet flaka nga shkëndija,  
Veç ky fill mbaron këtu!

Më rrëmbeu, thon' kjo vashë,  
Se ësht' shok në helm' e gas  
Zjarr u ndeza, kur e pashë,  
Porsi yll iu turra pas...  
Po, kështu nis dashurija,  
Kështu nis e kështu rron.  
S'është flakë nga shkëndija,  
Eshtë djell, që s'perëndon!

## LUM TI, MËSUES!

Mëngjezi shkrepi, kodrat zbardhëllojnë,  
një erë e lehtë frys mbi trendelinë,  
Shihni fëmijt! Në shkollë po vrapijnë  
si tufa zogjsh që zbresin mbi lëndinë...

Lexo ndër sytë e tyre lumturinë,  
se ç'ditë e bardh' për ta po vegullon!  
Lum ti, mësues, çfar' miq që po të vinë,  
lum ti kë puth me mall e përqafon!

## NË ZJARR E FLAKË

### KY PRILL SIVJET

Ky prill sivjet si shënëndre  
mbi atdhe solli tufanin,  
na nxivi qiellin,  
na shojti diellin,  
na veshi zi vatanin!

Ne s'mund të vdesim ulur më  
gjunjë,  
qafën ta bëjmë frona!  
S'na tremb hordhia,  
na dhemb liria,  
na dhembin viset tonat.

E zjenë malet në katër anët,  
kushtrimi i madh gjëmoi.  
Në zjarr e flak,  
mbi tokën gjak  
flamuri i kuq valoi!

# OLIMBIA

poemë

## I

Ç'ësht' kjo gjëmë, ky të qarë?  
Thomëni kush qënka vrarë?..

Jani Balit, trim me nam,  
qehajaj vëllanë i vrau!  
Vetë e ngre Jani vëllanë.  
sytë e mekur vetë ia lau...

Vetë e mori në kurris,  
ia çoj nënës në shtëpi.  
— Nëno moj, vëllaj si lis  
ra përbysës në dhe të zi!

Kur e pa nëna të vrarin  
se c'i derdhi zemra lot.  
— Turru, bir, e veru zjarrin!  
**O ata ose ne sot!**

Turru, xhan, e merru hakun  
se të lanë pa vëlla,  
tërë jetën na pin' gjakun,  
vimë e shkojmë veç pér ta.

Nisu, bir, malit përpjetë,  
të jep nëna një dogra;  
nusen, çupën t'i mbaj vetë,  
do jem un' pér ta kala!

Nisu, bir, si val' e thinjur,  
që shkëputet nga përrenjtë,  
aqë e fryrë e aqë e nginjur  
rrugën çel nëpér shkëmbenjtë!

Nisu, bir, u bëj rrufe  
n'ato male me déborë!  
Bjeri hasmit dhe, po re,  
je pishtar që digjesh horë...—

Më shum' Jani s'kishte pritur,  
përmbi sup hodhi dogranë,  
nëpër malet ishte ngjitur  
tok me shokët partizanë.

U nis xhveshur si ata,  
po s'e ngriu furtuna kurrë!  
Mbi déborën shtroi dhe ra,  
po dhe bora ngrohej furrë!

Barkun thatë si ata  
ndoqi hasmin anembanë,  
e rrethuan, po s'u dha,  
e qëlluan, po s'e vranë...

Tok me shokët n'ato male  
sec luftoi e u pérpoq,  
iu hodh topit, s'pyeti fare,  
iu hodh flakës, po s'u doq...

Dhe kur malli për shtëpinë  
se ç'ia dogji zemrën zhurë,  
shtërngoi fort atë martinë  
edhe zemrës i vu gurë.

— Nëno moj, në qoft' se rron,  
a në dergjesh varrzbuluar,  
pushkën djalit ia dëgjon  
kur gjëmon e zemruar?

Nëno moj, edhe në rënça,  
pushka ime nuk pushon,  
gjakun tim dhe në e dhënga,  
bëhet dritë e fort ndriçon!

Nëno moj, po t'u vra djali,  
ke me mijra bij të tjerë,  
nëno moj, në të merr malli,  
puth ata e merru erë!

Ne një zjarr na ndezi gjinë,  
yll' i kuq na ndriu në ballë,  
Vajzën puthma, Olimbinë!  
Nuses, nën', m'iu fal me mall!

## II

S'sheh fëmi të lozë jashtë,  
se fryn vdekja orë e ças,  
u dogj gazi si fill kashtë,  
një kujtim farmaq la pas.

Gjithë strukur, gjithë mekur,  
futur mëmave në gji;  
ca q'u vran', në dhe jan' tretur,  
ca mben' rrugve pa njeri.

Sa kasclle trimash mali  
u shkoi flaka gjer në qiell,  
sa herë erdh këtu vandali  
doq e poq e shkoi në hell...

Olimbi, moj Olimbi,  
Pse nuk ha e pse nuk pi?  
Buka, ujët s'po të shkoka  
si fëllëzës në kuvli!

Vajza t'anë po kujton,  
mos ësht' vrarë e mos ka vdekur,  
mos ka plagë e mos rënkon  
n'atë shkëmb i vetëm fshtetur...

Në rrugos ku qëndron shtrirë  
gjyshen sheh që nangas zjarrë,—  
këto halle ç'e kan' mpirë,  
si skelet në tym ësht' tharë!

Brengën thell' në zemër mba,  
ç'gjak pikon zemra e shkretë!  
Dy djem pati, asnje s'ka!  
Po s'e jep, jo, vehten lehtë!

Nën' e trimit ndër ne s'qan,  
po për trimat bëhet krah,  
po ra trimi, gjë s'e mban,  
zjen, mallkon e vdes me ta.

Është nën' e partizanit,  
hallall qumshtin që ka pirë,  
Sytë e saj ia fal vatanit,  
i fal zemrën dhe të birë....

Plaka nusen kur e pa  
ambushur sytë rrafsh me lot,  
— Xhan, moj nuse, — se ç'i tha,—  
Zinë e shkretë ç'ma ndjell sot?...

Buzë vatrës Olimbia  
rrri menduar. Ç'po kujton?..  
I del para fëminia,  
me të sonte kuvendon!

Kujton kohën e kaluar,  
kur me Palin qeshnin, lonin,  
aty veç e të zemruar,  
aty bashkë prap pajtonin.

Kështu qeshnin, kështu losnin,  
kështu çel e mbyll mërinë,  
dy manaret larg kullosnin,—  
ata shtonin miqësinë.

Tani — mbyllur në shtëpi  
buzëplasur, zemërvrarë;  
çfrym kasollja tym të zi  
nëpër kashtë e nëpër trarë...

Po kur maleve me borë  
u nis Pali një mëngjez,  
se ç'i tha e ndezi horë,  
se ç'dëgjoi e flakë u ndez...

Dhe më s'priti, s'iu durua,  
i dha dorën dhe u ndanë,  
atij trimi ç'iu betua  
dh'u bë erë e tramundanë.

Mblodhi shoqe e shkoi nga zalli,  
mblodh inat e shtiu në gjë,  
mblodhi fjalë i çoi nga mali,  
priti shokët më shtëpi.

Një nat' vajt' e dogji barë,  
atë nat' pa yj' e hënë;  
kur e ndalën zu të qajë,  
kërkoj lopën, tha, që mbrëmë...

Brodhi hasmi vend më vend,  
ditë e natë mbajti vesh,  
aluriti sa s'u çmend,  
po nuk nxori gjë në shesh!

Fshati dinte, po s'thosh gjë,  
dinte fusha, po s'tregonte,  
dhe Gjanica<sup>1)</sup> s'bënte zë  
sa kish parë e sa dëgjonte,

Edhe gjyshes kur i thanë  
lumja ti çfar' mbese ke,  
qeshi pak e lott i ranë,  
kujtoi vehten çup' të re!

Dhe kur vajza natën von  
aqë e lodhur vjen të flerë,  
gjysh' e shkret' mbi kokë i shkon,  
fort e puth e i merr erë,

— Ty të ruajtë i madhi zot,  
se je prapë një fëmijë,  
s'di ç'ësht' lufta, s'ruhesh dot,  
partizan' e gjyshes, bijë!,,

C'ish gjëzuar Jani Bali,  
kur i thanë e i bënë be:  
— Jotë bijë shqipe mali  
krah për krah lufton me ne!

---

1) Lumë në Myzeqe.

Kish kënduar, hequr valle,  
kur dëgjoi se ajo rrон,  
atje lart ndér ato male,  
ku fryn erë e ku gjëmon,

III

C'po fryn era atij zalli,  
vjeshta rrëzon fletë,  
C'është ajo sarkadhe mali  
bregutë përpjetë?

Se ç'ia ngre, ç'ia fluturon  
kjo era shaminë,  
ajo ec e endërron  
vehten me martinë,

S'mund të rrinte më në fshat,  
andaj mori malin,  
Bëm'u shesh, o more shpat,  
sa të takoj Palin!

Ta takoj e sytë e shkruar  
t'i shoh a kan' zjarrë,  
rron a s'rron apo ësh't' shuar  
miqësi e parë,,

Ku ta gjej e kë të pyes,  
kush vall ta ket' njojtur?

Kujt t'i them se ç'zjarr m'u ndes  
dhe më s'është shojtur,,,

13625

Kështu thotë e fluturon  
flutura syshkruar,  
kështu thotë e endërron  
zemër-përvëluar,

Eshtë flak' e dashurisë,  
zjarr që s'bëhet hi,  
është dhëmbk' e miqësisë,  
që në vogjeli,,,

Kur iu ngjit malit në majë,  
qëndroi një cop' herë,  
mbi fshat hodhi sytë e saj  
për të fundit herë,,,,,

Vjesht' e zymtë, er' e marrë.  
gjethet përdhe shtrojnë,  
lumi i fshatit hiqet zvarrë,  
kasollet rënkojnë,,,

Dhe më larg një tym i zi  
ngrihet re stuhije,  
pastaj mjergull, shkrumb e hi,  
klithmë e kujë zije,,

Fush' e gjëre mbet skëterrë,  
nuk sheh këmb' njeriu,  
Olimbia pikë e vrerë  
sa fort pshëretiu:

— Pritna, pritna, o moj fushë,  
sa të vimë ne,  
të çlirohesh, të stolisesh  
porsi nus' e re!

Pritna, pritna, se gjaksori  
shpejt moj do mbarojë!  
Kështu tha e rrugën mori  
Palin të takojë,

Eci, eci gjer ndajnatë,  
po atë s'e gjet,  
— Folvë, xhan, o pyll i thatë,  
folvë pse s'më flet?

Ku ta gjej, o unë e mjera,  
atë që kërkoj?,,  
Po s'flet pylli, s'flet as era,  
s'flet edhe pérroi,,,

Lemzë, moj, dy dit' pa ngrënë  
ç'ke që më trazon?  
cili malli ta ket' zënë  
dhe po më kujton?

More zogj që fluturoni  
duke ligjëruar,  
hidhni sytë dhe vështronë  
ku vall ka qëndruar!

Kam tër' ditën, të m'i thoni,  
atë kam kërkuar,  
në ka fjetur, të ma zgjoni  
duke m'i kënduar.

Në ka plagë e në rënkon  
frymën duke dhënë,  
le t'ia thot' ngadalë këngës  
sa t'i dëgjoj zënë!

Në ka rënë e është vrarë,  
merrni një grusht dhe,  
verjani zemrës ngadalë.  
dhe shihni si rreh.

Dhe ahene do shikoni  
syri ç'flakëron,  
dhe të vdekur, do besoni,  
trimi gjithnjë rron!..

Olimbia e këputur  
nënë lis u pshtet,  
lehtas mbylli sytë e bukur  
dhe si shqerka fjet... .

#### IV

C'janë ata që zbresin malit  
dhe këngës ia thonë?  
C'u shkëlqen në mes të ballit  
yll' i luftës sonë!

Se c'u ngre era shaminë,  
që u skuq si gjaku,  
hedhur krahve një martinë  
me kollan shajaku.

Gur më gur c'ia thonë zallit  
fëllëzati malore.

Olimbia zbret prej malit  
me 'j bari për dore.

Me barin' sa plasur dherit,  
sy e faqka tretur,  
gjeti çetën mes zabelit,  
gjet dhe Palin pshtetur.

Me të gjithë u përqafua,  
ç'mall ta kishte zënë,  
kush e di sa vite thua  
shokë e miq kan' qenë.

Shokët qeshin me çobanë,  
që do pas t'u shkojë,  
që me trimat partizanë  
mburret të luftojë.

Yjtë ndizen si shkëndija,  
hëna kaptoi malin.  
Ç'ësht' gëzuar Olimbia  
që takoi me Palin!

Kur u panë, me ç'gëzim  
syri gufoi mallë,  
tha më shumë ai vështrim,  
se sa mijra fjalë...

Se ç'janë ulur mbi lëndinë,  
ashtu si dy zogj,  
po at' mall që u ndez gjinë  
nuk e zbrasin dot.

Hën' e bukur që m'atë anë  
Embël m'i kundron,  
ç'u ka zbritur aty pranë  
dhe m'i ledhaton.

Për karshi mbi shkëmb të thatë  
shqipja ka qëndruar...  
Fjal' e tyre her' merr flakë,  
herë rrjedh e shtruar...

Njeri tjetrit s'ia thon' dot,  
skuqen, turpërohen,  
syr' i ndezur le ta thotë  
zemrat ç'përvëlohen...

\* \* \*

Pa shiko barinë e shkretë  
si u turret pas.  
— Xhane, thot', të vij në çetë,  
se kështu do plas!

Flet e qan me lot e kujë  
dhe prej tyre s'ndahet.  
— Merrmëni që t'ju mbush ujë,  
buza kur t'ju thahet!

Do luftoj si ju dhe unë  
dhe ashtu do bje,  
s'kam vëlla, po djemka shumë  
nënës do t'i le!

Dhe në s'kini një martinë  
të ma jepni mua,  
merrmëni zbuluës dhe shihni  
po s'u bësh fajkuat!

Merrmëni që t'ju lidh plagët,  
në u zëntë plumbi,  
merrmëni t'ju lidh me shokët  
më shpejt se pëllumbi!..

Ata qeshin e gëzohen  
me këtë petrit,  
si e puthin, zënë i luten:  
— Prit, moj shqipe, prit!

Prit të rrithesh edhe ca  
dhe pastaj të marrim.  
Je i vogël, kalama,  
s'e duron dot zjarrin.

— Në s'të muarm' këtë radhë,  
dëgjo Olimbinë,  
ti mos qaj, pëllumb i bardhë,  
se ne prap do vimë!

Kështu thanë edhe u çuan,  
therën poshtë zallit,  
kaqë i thanë e fluturuan  
shqiponjat e malit...

— Plaq, moj zemër, si vullkani  
që më rreh në gjë!  
Ti je zjarr, — rënkoj çobani, —  
unë cilimi!

V

Er' e çmendur vërvhellen  
atje tej në pyll të thatë,  
dimri i madh që po na vjen  
nxori kosën këtë natë.

Te kasollja e gjysh Xhezarit  
Pali mik na paske ardhur.  
Olimbia pranë zjarrit  
këmbët ngroh, q'i kanë mardhur.

Fjal' pas fjale muhabeti  
se ç'u ndez për bukuri...  
Eh, — thot' plaku, — unë i shkretë  
kur nuk qeshë pak m'i ri!

Dhe un' pata zjarr në gji, —  
buzëplasur mendon plaku, —  
derdha djersë e korra zi,  
po kështu nuk më vloj gjaku...

Moj Parti, të qofsha falë,  
ndeze zemrat anembanë!  
Tunde fushën, tunde malë,  
ndaj ty trimat shpirt të kanë!

Trim i madh yt at, moj bijë,  
po dhe ti s'më, dukesh pak.  
Po lëshoi ky sy shkëndijë,  
ta dish zemra digjet flakë!

Muhabeti kish marr' shtruar,  
kur u dha një trüm në derë,  
frymë merr duke gulçuar,  
lodhja këmbët ia ka prerë.

Mezi tha nja dy-tri fjalë:  
— Partizanët jan' rrëthuar!  
Zor të mbetet një i gjallë,  
zor ndonjë për të shpëtuar!

Kaqë tha e u bë erë,  
kaqë tha e fluturoi,  
shkoi trokiti der' më derë  
dhe, në flinin, vajt' i zgjoi!

Aher' plaku na ësht' ngritur,  
mori pushkën dhe e pa,  
sytë e tretur ç'i kan' ndritur  
dhe një lot i nxeh të i ra...

Pastaj rëndë pshëretiu.  
— Pleqëri, — tha, — u shkretofshi!  
Nga t'ia mbaj sot unë i ziu?  
Pse moj sot të më turprosh?..

Ngreu, moj bijë!.. E meriton  
Rrëmbe pushkën, që rri fshehur!  
Ja, dëgjo se si rënkon  
pa fishekë e këmbzë-shkrehur!

I sheh plaku që të dy  
n'errësirë si vrapojnë,  
deri larg i ndjek me sy,  
kur si shqipet fluturojnë... .

Kështu trima, shqipe mali  
Që dhe vdekjes nuk i friken  
s'më pan'sytë... Zot, ti fali,  
Se janë trima që po rriten

## VI

Zvarrë e zvarrë e këmbë e duar,  
herë shpejt e herë shtruar  
shkëmb'e shkoza kan' kaptuar...  
Lufta vlonë për karshi!

Rrinë shtrirë e po dëgjojnë  
pushkë e bomba si gjëmojnë,  
partizanët q'po qëndrojnë  
porsi shkëmbi në stuhi!

Pushk' e tyre vec gjëmon  
dhe, kur rrëthi i shtërngon,  
gryk' e malit ç'po vajton  
për ata që bien fli!

Turren trimat, po më kot, —  
ky rrëthim nuk çahet dot!  
Vrarë e prerë trima plot,  
vrarë e prerë për liri...

— Ti rri ruaj, — i tha Palit  
Olimbia është u nis, —  
do t'i ngjitem zvarrë malit  
mitralierin ta vithis!

Do t'i shkoj ngadalë prapa,  
mitralozit t'i mbyll gojën.  
T'u them shokve: Shteg ju hapa!  
Pa pastaj le të mbarojë!...

— Dale, xhan, moj Olimbi, —  
u gjegj Pali e iu qas. —  
Ku do vesh pa mua ti?  
Këtë zemër mos ma plas!

Un' të desha dhe të dua,  
shok nuk pata përmbj ty,  
se je shqipe dhe fajkua,  
ndaj do vdesim që të dy! —

Gjith' kjo jet' me halle shumë  
se ç'i bëri zogj me krahë,  
si zgalemit në furtunë  
zemr' e tyre zu të rrahë;

si zgalem, që sheh stuhinë  
edhe sytë e tij shkëlqejnë,  
s'pyet pér valët që po vinë,  
në e mbytin, e rrëmbejnë,

ai turret te rreziku,  
guzimtar me gaz lufton,  
edhe vdekja në e çiku, —  
këng' e tija prap jehon! ..

Shtjer, moj push' e trimit, shtjer!  
Digje hasmin flakë e zjarr!  
Merrma shtruar si ngaherë, —  
shokve shteg e hasmit varr! ..

O eses, o moj kolerë,  
s'i tremb lot trimat e malit,  
se jan' gjak me zjarr përzjerë,  
se kanë yll në mes të ballit!

Shih si fryn tufan' i marrë,  
ata xhveshur e pa ngrënë;  
shih opingat ç'heqin zvarrë,  
thonjtë e këmbve ç'u kan' rënë!

Po ata s'duan t'ia dinë,  
rrufe bëhen, të përlajnë,  
bëhen zjarr e ty të shkrijnë,  
thèllim bëhen e të thajnë!..

Dhe u sulë shqipe mali,  
i van' hasmit aty pranë,  
zjarr' i vdekjes dot s'i ndali  
dhe një plumb në gjoks i dhanë.

Dhe esesi i xhindosur,  
gojën shkumbë e syçapluar,  
klith si derri q'është' plagosur,  
kërkon gjak të pij' me duar.

Përmbi Palin ç'u värsul,  
i ngul thikën mu në zemër!  
Dhe ai trim, që s'u përkul,  
bëlbëzoi ngadal' një emër...

— Olimbi, moj lul'e malit,  
bëmu krah e hidhu ti,  
pastaj yll' e kuq të ballit  
të ma vën' shokët në gji...

E kur ra u plas përdhe,  
dhe një her' pa Olimbinë,  
sikur desh t'i bëjë bë  
ta mbaj' ndezur dashurinë...

— Prit, dushman, se kam një fjalë!  
Ta marrç vesh sa dhembti thika! —  
Sulet hasmi, po në ballë  
plumbi i saj shakuill e shtrika!

Dhe me gishtat lyer gjak  
si hienë dhen' gérmon.  
Ndoshta varr' e tij po hap,  
ndoshta gjak nga dheu kérkon...

## VII

Bie bora flokë-flokë,  
të merr frymën kjo duhi.  
Olimbi, moj, shko ndër shokë,  
se kështu qesh syr' i ti!

Shokët mbëdhur aty pranë  
shohin trimin që mbaron...  
Dy-tri pika lot u ranë!  
Luft' e egër larg gjëmon.

Në mes tyre Jani Bali  
gjunjëzuar puthi trimin,  
yll' e kuq peshqesh ia fali,  
grushtin ngritur bën betimin..

Dhe Xhezari q'ësht' me ta  
e tund shkopin dhe betohet:  
Pali rron, thot', dhe në ra  
vend' i trimit kështu mbrohet!..

Nëpër male fryn stuhi,  
çeta trime ngjitet malit;  
hap më hap flet zër' i tij,  
tok me ta kjo zemra e Palit!

Olimbi moj, udh' e mbarë,  
këmbëzbathur çaj stuhinë!  
Dhe në marrtë kurmi flakë,  
kujto shok'n e dashurinë!

## LAPIDARI

— Nëno, ç'është lapidari?  
pyeti djali i vogël-o  
— Ësht'kështjellë, o bir, prej zjarri,  
ku mbuluam zemrën-o!  
Ja atje, o bir, atje  
ç'u gremis një lis përdhe,  
e jo një e dy e tre...  
Jetën dhanë, o shpirt, për ne!  
Që të gjithë shqipe mali,  
që Partia krahë u fali,  
o biro!

— Po përse luftuan, vallë?  
Ç'shokë kishin, ç'emër kanë?  
— Ata ishin trimat-o  
me një yll të kuq në ballë,  
bijtë e nënës partizanë!  
Gjoksi i tyre blojti hekur,  
gjoksin tanksit i kan' vënë,  
fyt për fyt me të jan' zënë,  
fyt për fyt me të kan' vdekur!  
Ata ndezën, bir, një dritë —  
mbi atdhe po ndrit si djellë!  
Te ky vend, ku lan të ritë,  
te ky vend, te kjo kështjellë!

## II. NETËT PA HËNË

---

### G NENE!

O nënë, që linde njerinë,  
q'e rrite me vojtje, mundime,  
dhe i ndeze në gji dashurinë,  
sa fort t'adharon zemra ime!

Kujtoj ato netët pa hënë,  
kur çfrynte tufan' i tërbuar;  
si klloçka na mblidhje, o nënë,  
te vatra e varfër, e shuar.

Dhe nisje tregoje ngadalë  
një prallë të gjatë, moj nënë,  
me lote na qullje çdo fjalë,  
sa gjumi na merrte pa ngrënë.

Dhe ditët kalonin e unë  
të lutsha: Nënoke, mos qaj!  
Se doçkat m'u rritën për punë,  
kafshatën me ju do ta ndaj!

Ti qeshje. Ndër lote shpresoje, —  
një shpresë për diell në stuhi, —  
dhe flokët me mall m'i lëmoje  
dhe zemra të hidhej në gji...

---

*Shënim.* — Nën titullin e përgjithëshëm «Netët pa hënë» janë përmbledhur vjersha të shkruara para çlirimt të atdheut, kryesisht në vitet 1938-1942.

Tashi ti më kalbesh në dhe,  
jetimat mbi varr të kërkojnë;  
si nata e heshtur ti fle,  
veç lulet mbi ty kundërmojnë...

### KJO NUK ISH PËRALLË...

Në të ri, moj motër, një çupë kërcure,  
si fëllëz' e malit mbyllur në kuvli;  
bota jote ndrydhej veç në katër mure,  
ç'të dridhej si zogut zemra mu në gji.

Atë që s'e deshe ta dhanë për burrë,  
shpejt të vu çarçafin, të veshi në zi,  
u ndave nga shoqet, me to s'fole kurrë,  
me djemkat që lojte zure mban mëri.

E prapa kafazit trete zjarr'e mallë,  
ti, fëllëz' e malit mbyllur në kuvli!  
Kjo nuk qe një ëndërr, kjo nuk ish përrallë,  
po qejeta jote: vaj e lemeri!

### T'U HARROFTË EMRI...

(variantë)

Iknë burrat, iknë, iknë e muar dhenë,  
gruan dhe fëmijët lanë në fole,  
për të nxjerr' kafshatën koskat larg u mbenë,  
porsi milingonjat gërmuan në dhe...

Iknë burrat, iknë, muar arratinë  
dhe u lan' shiendënë me dy pika lot;  
nënët, nuset pritnë, si pret lulja shinë,  
po si lis i prerë më s'u ngritnë dot!..

T'u harroftë emri, o more kurbet,  
që na humbe burrat larg e larg mërguar,  
ata van' të nxirnin kafshatën e shkretë,  
ti u solle zinë në vatrën e shuar...

## IA RUAJ ZJARRE...

Notoj ndër valët e dëshpërimit,  
po shpirtit tim ia ruaj zjarrë!  
Dhe kur kët' natë do e zbojë agimi,  
do them: — Në parzëm s'ka vend trishtimi?  
O zemra ime, këndo beharë!

## SHIKO TCKËN

Ata lotë  
që dikush ka pikuar  
s'ju trokasın në zemër?  
Hymn' i zjarrtë i përlotur,  
që rëndon ndër të mjerë,  
s'ju troket mu në zemër?..

Plot me qejfe e shkon jetën fqinja ime  
dhe shijon yjtë e qiellit që vallzognë  
dhe s'dëgjon  
në kasollen me dëborë psherëtimet,  
as fëmijët që për bukë po vajtojnë...  
Ndër të errëtat kasolle shoh një dritë  
ndaj të fikur...  
Një kollitje — hymën zije!..  
Yjtë tallen me të mjerët poshtë?!  
Oh, çuditë  
e një bote që s'ka pikë dhemshurije!...

Asohere ze rënkoj papushuar  
dhe rënkim i ma përzhit zemrën time,  
sepse shoh që me lot jan' mbuluar  
sërë shpirtrash...  
Oh, mallkime!

Vlla,  
nga sytë që jan' zgurdulluar.  
nga dy sy si dy gropë skëterre,  
me një shpirt aq të pastër,  
të vuar.  
të ushqyer me rënkim e me vrerë,  
mos vështro yjtë e hënën e qiellin,  
e dritën e motit e diellin  
dhe herojt e mëshirës,  
a uratën punëboshe përherë!..  
Shiko tokën!  
botën e mjerë!  
Shiko,

### **III. KËNGA JOTE TË BUÇASË**

#### **MOJ E BUKURA UZINE**

Moj e bukura uzinë,  
mun si gjak na shton fuqi!  
Hapi krahët, hape gjinë,  
pritma, puthma puntorinë!

Njëqind kate m'u rritsh tinë,  
që zbardh ditët që po vinë!  
Dilu shoqeve përpara,  
hiqe vallen, moj uzinë!

Hiqe vallen me shaminë  
dhe këndo një këngë tinë,  
kënga jote të buçasë  
hymn lavdie për Partinë!

#### **KËNGA ZJEN SË LARGU**

Ku vashë pranvera shket mbi fije bari,  
mbi sup'n e poleskës, fill margaritari,  
ku trim i fustanes prehet një cop' herë  
mblidhet pleqësia mbrëmave në verë...  
Ja për të kënduar, ja të kuvenduar...  
Sa gëzim që sillka kjo punë e bashkuar!

Në rrëzë të malit, atje mbi lëndinë,  
ku dash' i këmborës kullot trendelinë,  
djemtë çlodhen mirë, djemtë pun'-mbaruar  
pa zënë e ia thonë këngës më të shtruar,  
dalë e me ngadale gati për ta shuar,  
pa zënë e këputin si lot'n e kulluar —  
mbi mollzat e fakes zbehur dhemshurije,  
pa zënë edhe e ngrejnë me hov djalërije!..  
Pleqtë të mallosur, mbytur me kujtime,  
këndej venë veshin... andej psherëtime...

Kënga zjen së largu, këng'e dëshëruar,  
këng' e vendit tonë, këng' e pambaruar...

### ROJES

U gris cip' e natës, yjtë zënë e shkrihen,  
ndër malet e larta nis të zbardhëllojë,  
shtëllungat e tymit nga fabrika ngrihen,,  
shqiponj' e përgjumur ku do fluturojë?

Qesh Adriatiku... Varkat fluturojnë...  
Nisin e gjëmojnë siren', e traktorë...  
Roja jonë trime, sot me ty qëndrojnë  
roje të atdheut fshatarë e puntorë!

Roje le të rrin' dhe vargjet e poetit!  
Kënga e dashnores roje le të rrijë!  
Le ta rrahë shkëmbin dallg' e zymtë e detit!..—  
përmbi shkëmb'e valë zot éshtë' dora e tij!

## **IV. KY ZJARR NË KRAHARUAR**

---

### **DALE MOJ E FOLMË TI**

Moj konxh' e lules me pala plot,  
një kopsht mbushe me erë,  
po ky zëmbaku ty s'të flet dot,  
se gjuhën ia ke prerë!

O dale moj,, e folmë ti,  
mos rrëi kështu zëmruar,  
se faj'n e ka ky mall në gji,  
ky zjarr në kraharuar.

Se faj'n e ka ky syr'i bukur,  
qerpikët halë-gruri,  
e buzë e faqe si shegë e skuqur,  
ku digjem un' kërcuri...

Oh folmë ti, pa të dëgjosh,  
tër' zemrën do ta zbras!  
Me ty në arë a ku të shkosh  
sì yll do turrem pas!

Më fol, o vashë, mos mbaj mërinë,  
t'ia nisim këngës sot;  
pastaj të ngremë mbi dashurinë  
folen' me zoçka plot!

## PA DËGJO Ç'KENDON BILBILI!

Pse më ikën si veriu,  
o moj vasha engjëllore,  
më mbyll syçkat, ngre përpjetë  
vetullat si gjarpërlore?  
Nuk shikon si puthen zoqtë?..  
Njëri tjetrin dashurojnë!!  
Nuk ve re si kafen yjtë?..  
Njëri tjetrin adhurojnë!  
Pa dëgjo ç'këndon bilbili  
mun te gjir' i trëndafilit!  
Pa nuhat flladin e ëmbël  
në agim'n e shpejt' të prillit!

## — FRYMEZIM —

Djelli ndaj të perënduar  
përshtëndet me rreze t'arta  
gjithë fushat, gjithë kodrat,  
gjithë malet më të larta,  
pastaj prez' e tij e fundit  
tretet heshtur nëpër valë  
qielli endur ngjyra-ngjyra,  
Si mëndafshi palë-palë..  
Ulet djelli prapa malit  
Dhe më s'duket drit' e tija  
gjith' rrëmeti hyn në gjumë,  
Zun' platiten shpeshërija

Dhe saher' ky qiel qëndisur  
plot shkëndija, yj' qiellorë,  
ujë-argjëndi murmuron,  
fllad' i émbël e lëmon,  
hëna del si vasha ime  
sipër malesh me dëborë,  
asohere ndjej që brënda  
duf'n e math që frymëzon...

14/15

## DESHIRE

Dua të të shoh, vashë, me kurorë,  
natën kur tër'jeta në gjumë ka rënë,  
këngës ne t'ua themi, si ç'ia thot' kjo hënë,  
që dremit gazmore maleve me borë.

Dua të të shoh konxhe plot me erë.  
Në kopësht të vemi, ku moj të kam gjetur!  
Dh' ashtu përqafuar, buzëtë pështetur,  
të dëgjojmë zemrat si rrabin paprerë,

Kështu të të shoh, të të marr në gji,  
ty moj që mbi shoqet çquan porsi hënë.  
E gjersa mbi fushë djelli të ket' rënë,  
të flasim për mallin që na djeg në gji...

## SOT TË NJOHA

Vjet të pashë... Sot të njoha,  
moj burbuqja dashuri!

Fjala jote ç'më premtoka  
gaz në sy e zjarr në gjii..

Vjet të pashë... Sot të njoha,  
dashuri, hej, gaz me lotë!  
Çelet zemra... Çelet koha...

Ndizen yjt ndër qiejtë e ftohtë,,,

## ENDERRIM

Se ç'i mbyll sytë e ëndërroj  
sikur me ty po flas,  
pa duart shtrij të të pushtoj  
dhe buza çel në gas.

Çdo ças, moj vashë, të kujtoj.  
Dhe kur traktorin ngas,  
nga malli yt un' fluturoj  
dhe shokët i le pas...

Dhe zemra ime në krahëruar  
sa fort më rreh për ty,  
se këtë zjarr që s'kaltë shuar  
má petveç ti ndër sy!

## ASAJ

Zu e çel zëmbaku porsi gusha jote,  
u ri hën' e qiellit si ti magjiplote,  
syri yt i shkruar më vështroi ngadalë,  
ky vështrim' i tija më mbyti ndër lote.

Lotet që kam derdhur s'ma shtuan mërinë,  
vasha ime e shtrenjtë, vashë trendelinë;  
zemra rënkoj rëndë, porsi det me valë,—  
sot që buzëgeshe këndoi dashurinë!

## TE MË VISH DHE TINË..

Se sa kam dëshirë të më vish dhe tinë,  
të shkojmë ndër pyje, të shkojmë ndër stane,  
se atje ndër male gjejmë dashurinë.

Atje yll' i qiellit këputet si loti,  
atje këng' e vuar ze rënkon si valë.  
pa dhe këng' e madhe ia zjen si qëmoti.

Të më vish dhe tinë, që të dalim pyllit,  
ku rrëmbehen vashat nga trimat e malit,  
ku stolisen vashat me stolinë e yllit.

Pa shkojmë në mbrëmje ku dremit çobani,  
atje mbi lendinë, ku ka trendelinë,  
pa i fshehim enët, ku ka ajkë stani.

Pa i marrëm fyellin, ku fsheh dashurinë,  
pa po, kur të zgjohet, le të na kërkojë,—  
fyellin s'ia lëshojmë, bashkë do t'i bimë!!

## EJA, FLUTUR EJA!

Të fola me zjarr, moj flutur e mitur,  
kur tē pashë fushës ndaj losnje me shoqe;  
malli ishte ndezur, ylli kishte zbritur,  
e sumbul' e vesës ndrinte magjiplote.  
Të fola me zjarr, zjarr që djeg nē zemër,  
fluturzë pa fjalë, fluturzë pa emër..

Të pashë me shoqet, lil mbi trendafilë,  
buzën më tē qeshur, syrin më tē qarë,  
sikur tretnje vjeshtën, sikur çelnje prillë,  
sikur endërronje dashurinë e parë.  
Të pashë ndér shoqet, fluturzë pa emër,  
fole moj një fjalë, tē thérret një zemër!

Deshà tē tē zinja, ndaj renda aq rëndë,  
po ti fluturove nga lulet me vessë,  
ahere së largu tē ndoqa me këngë,  
këng'n e dashurisë, këngën plot me shpresë,  
Të thirra me qeshje, tē thirra me lot,  
po nga tē dy këngët zemra s'tu hap dot.

Eja, flutur, eja tē tē çik pér dore,  
si çik buz' e vashës valén argjentore...  
Është agim, moj motér, pse merr arratinë?  
Yjet janë tretur, hëna ësht' këputur,  
lulet janë zgjuar, krojet psherëtijnë...  
Eja, vashë, eja, fluturo si flutur!

## MË THIRRE SHOQET

Më thirrë shoqet ndaj mugëtirës  
të niseshim për lule,  
ish motr' e gazit, motr' e dëshirës  
dhe un' zoga pekule.

E dor' pas dore me vrap sarkadhi  
fundosëm nëpër grurë,  
se mës na shih te mustaqemadhi,  
që s'na kish parë kurrë;

pa zjente fjala që shkonim malit  
e merrte dhenë, o zot;  
pa po na plaste dhe cip' e ballit  
e s'kish kush na mban dot...

Pa ikm' e shkuam gjer te kodrina  
si flakë të djersitura,  
pa lamë llërët nëpër mburima  
dhe syçkat e dremitura.

Pa mblozhmë lule sa desh dëshira  
dhe nismë nga një këngë:  
— Lule, moj lule, kush ësht' m'e mira  
për atë trim'n e rëndë?..

— E di, moj, zemra çfar' ju ka ënda!—  
na foli luleferra.—  
Trimin e kam mun këtu brënda,  
po ikni, moj të zeza!—

Pa ulmë kryet... Ç'u turpëruam  
me këtë trim zuzar!

Pa s'ditmë vehten nga vamë e shkuam,  
e zemra digjej zjarr...

Pa Trendelina faqedjersitur  
na thirri: — Mbeç kêtejza...  
Oh plaç, moj zemër, që kaq tē mitür  
më le ne luleferrza!..

## DY AXHAMINJ

Kur vjen mbrëmj' e vagëlluar  
gratë bisedojnë:  
Nasi, Lena ç'jan' harbuar,  
fshatin po turpërojnë... .

Yjtë ndizen, yjtë shkrihen,—  
ata përqafuar!  
se ku shkojnë e se ku fshihen,—  
kot për t'i kërkuar!..

Po t'u flaç, tē mbajn' mëri.  
e s'të flasin kurrë!  
Po t'u vesh dorën në gji,—  
digjet zjarr si furre... .

Po t'i ndjeksh, kur zenë e fshihen,—  
ata fluturojnë!  
Po dëgjove se po zihen,—  
dije se këndojojnë... .

E pastaj nesër me natë  
në pun' do t'i gjesh,  
qysh punojnë sa për shtatë;  
goja fol e qesh... .

Ja kështu dy axhaminj  
fshatin ná türpruan...  
Dhe ne qem' si ata të rinj,  
po kaq s'u harbuam!

## ANDEJ FSHATIT TONE

Andej fshatit tonë,  
nëpër ca lëndina  
plot me bár të njomë,  
plot me trendelina,—  
anemban' mburima,—  
ftohen nëpër hije,  
njomin buzët trima  
ndezur dashurie,,,

Atje ndër kodrina  
venë e mbushin ujë...  
Vashë Trendelina  
bën të madhen bujë,  
Pa po c'm'i ka hije  
buz' e skuqur flakë,  
ndezur dashurie  
si yll me bajrakë!  
Syr' i saj i shkruar,  
syr' i saj si det,—  
dhëmbj' e pahruar  
gaz me të vërtetë!

Trimi shkon menduar  
dhe rënkon ngadalë,  
sy-për-sy shikuar  
i thot' dy-tri fjalë:  
— Moj gush' e zëmbakut,  
që çel në pranverë,  
as ma çik së pakut  
buzënë një herë,  
buzën e etuar,  
buzën përvëluar?...  
Vajza buzëkuqe  
porsi lulukuqe  
ç'na çelke burbuqe,  
çelur ndaj agimit  
mun në gji të trimit....

### SHOQET MË MBAJNË MËRI

Shoqet më mbajnë mëri,  
vesh-më-vesh ato se ç'thonë:  
sikur s'imblichem në shtëpi,  
sikur prisha un' zakonë...  
Shoqe moj, zemrën që kisha  
as e theva, as e prisha,  
po ia dhashë trimit-o,  
që nderoka fshatin-o!

Flasin shoqet, flasin gratë...  
Flisni, shoqe, sa të doni!  
Po kur fshati do ket' dasmë,  
ju moj, ju do më këndoni:  
— Sa ta kemi moj, zilinë,  
që e shkele sot zakonë!  
More bash'n e djemve tonë,—  
e gjëzofsh, ti dashurinë!

## TE TE THEM...!

Të të them si lule, po ti je m'e bukur!  
Të të them je konxhe, të cënoj freskinë!  
Mu në zemrën time fellë më je futur,  
mos, për kokën tënde, mos më mbaj mërinë!

Fol e qesh me mua, çele dashurinë,  
t'i këndojmë bashkë jetës që po ngrihet,  
Vështrimet e tua, oh, ç'ma ngrohin gjinë,  
si ngroh rrez' e diellit lulen kur gëdhijet,

Të të them si lule, konxhe palë-palë,—  
po ti je m'e bukur,,, E ç'të them pastaj?  
Ndaj më lidhet gjëha, s'të them dot një fjalë,  
skuqem, turpërohem si fajtor pa faj...

## ELEGJI

T'u mekën sytë, t'u zverdh kjo faqe,  
t'u ligën doçkat, kurmi t'u tret,  
pa vare kokën si manushaqe,  
sëmundj' e shkretë shërim nuk gjet!

Kur hiqnje shpirt, kur mbyllnje sytë,  
fëmijtë e vegjël një çast kujton..  
Mbaruan endrrat! Ti vetë i dytë  
si fletë e vjeshtës përdhe mbaron!

Moj dallandyshe, zoçkat kërkojnë  
t'i ngrohc me mallë, t'i nkosh të hamë;  
m'i le të mitur, ndaj cicërrojnë,  
kërkojnë mëmien ta kenë pranë!

Kur takoj nxénësit, sikur më thonë:  
Ç'u bë mësuesja, ku vajt' e shkoi?  
Ajo pat thënë me ju gjithmonë  
jetës së bukur do t'i këndo!

E dredhin buzën si më të qarë,  
te sytë e tyre sot s'paska gas!  
Ndër ato faqka një lot ec zvarrë,  
dhe loti lotit i turret pas...

Lundroj i mjeri në det me valë  
si lundërtari që çan stuhinë,  
Zemra më digjet e qan pa fjalë,  
se humba shokun dhe dashurinë!

## TE ZU DJELLI FAQET

Të zu djelli faqet, të vuri kurorë,  
dhe ves' e mëngjezit të spërkat shaminë,  
ti duke kënduar se ç'më nget traktorë,  
tufa-tufa zogjtë prapa po të vinë...

Ti, moj traktoriste, lulja manushaqe,  
që me djersën tënde fusha end stolinë,  
në të nxiu traktori dorë e gushë e faqe  
ti m'e bukur bëhesh, më shum rritesh tinë!

## I. TE SHKOLLA MBI LENDINË

### FESTË PËR SHKOLLËN E RE

Atje mbi lëndinë se ç'u ngrit një shkollë,  
na ësht' mbledhur fshati, s'ke ku hedh një mollë.  
Burra, gra, fëmijë fshati na ësht' mbledhur, —  
shkolla do festuar, vallja duhet hedhur!

Lumja ti, moj shkollë, zemrën ç'na gëzon,  
kjo pranverë e bukur stolinë ta shton!  
Nesër, oho nesër, dhe në fshatin tonë  
do ketë inxhinerë, do ketë agronomë!

### MIREMENGJEZ, O DJELL!

Kur djell'i vagëlluar u derdh përmbi liqerë  
Mësuës, ti ngjitesh bregut me trastën mu në shpinë  
Dhe ecën aq' i qeshur, si dita në pranverë  
E ndizet zjarr' i zemrës te syri shkrepëtimë...

Të pret ty fshat' i tërë te shkolla mbi lëndimë,  
Se nesër nis mësimi... festim gjer të gëdhihet  
Kudo që hedh vështrimin, kujton krenar lavdinë  
E luftës Çlirimtare... e jetës që po ngrihet ...

Fëmijët vin' në shkollë si lulet plot me erë  
Dhe ti me punën tënde i rrit ata për ditë  
Në faqe t'abetares vështron me mall Enverë  
Dhe ndjen sa rritet zemra, kur vjen të japësh dritë

Ti rihesh e pértrihesh, se nesër ky fëmijë  
Të vjen në mes të fshatit teknik që ngre të renë  
Ja, ja si duket djelli, mbi fshat fillon të ndrijë  
Dhe djemt' e abetares, heronj pér mëmëdhenë..!

### TE RRUGIC' E MALIT...

Te rrugic' e malit të shoh si vrapon  
dhe thëllim'i ftohtë doçkat t'i ka ngrirë,  
opingat e vjetra balta t'i mbulon,  
hunda t'është skuqur, buzët të jan' nxirë.

Palltua arne-arne, brekushet shkurtuar,  
librat nën sqetull me ç'mall i shtërngon!  
Buzëqeshesh rrugës duke endëruar,  
dhe thëllim' i erës flokët t'i trazon.

Le të griset palltua, le të fryj' thëllimi,  
le të jetë e gjatë rruga pér atje! —  
ty asgjë s'të ndalën, lajmëtar agimi,  
dallandysh' e parë pér jetën e re;

### NE KLASE

Kujtoj sa gjak u derdh, oh sa dëshmorë,  
ç'gjëmuani malet, fushat anembanë!  
Në mes të flakës kurmi u dogj horë!  
Nata u shemb, dhe drita varg kurorë  
u puthi sy e buz' fëmijve tanë.

Një mall i zjarrt' ma ndez përbrenda gjinë,  
kur sytë e tyre ëmbël më vështrojnë...

Mësuës, më thon', ta falmë dashurinë,  
po ndritna rrugën, rritna për lavdinë  
e jepna krah' më lart të fluturojmë!

E um' gëzohem fort që rrit njerinë.  
Gëzim të till' kjo zemër s'e pat ndjerë!  
Oho, ky diell i bukur që ka lerë  
Sa fort më g'zon, trefish ma shton fuqinë!

## KURSISTAT

Aher' kur vjen ndajnata dhe yjtë zënë e ndrijnë  
kursistat, porsi krushqit, me gaz te shkolla vijnë.

Kam parë varfërinë, kam njojur të urtuar,  
që për të shkretën bukë u sul' në fund të detit...  
Atë etje vështroj sonate sytë e flakëruar  
t'ia thonë dhe ata këngës me zën' e alfabetit!

Le të kujtojnë sonate si rrinin nën dritare  
dhe deshnim, oh sa deshnin, mësimin të dëgjojnë;  
po zi e shkretë i flaku barinj me një zambare  
atje ku shkrep rrufeja dhe maletë gjëmojnë!

O ç'gaz që shkrep ndër ta, kur shkronjat bëhen emra!  
Ky gaz më rrit dhe mua, kjo këngë më gëzon!  
«Parti» shkruan të gjithë, — të tjerat i tha zemra,  
që sot ka zën' e rritet e qeshet e këndon!

## GËZIMI IM

Pse sot me buz' të celur ti shkollës i afrohesh?  
Provimet ja tek erdhën dhe ti do ligjërosh,  
do thuash fjalën tënde... Sa fort ti më gëzohesh,  
ty krahët po të rriten, ti shpejt do fluturosh!

Provimet ja tek erdhën dhe zemra rreh me gas,  
në sytë e tu shoh mallin që ndizet i pashuar;  
sa bukur lulëzove, sa mir' më ndoqe pas,  
ç'kuptim m'i dhe ti jetës, ç'gëzim në kraharuar!

## MË NGJAN NJË FLUTUR

Më ngjan një flutur, kur shkon në shkollë,  
ti konxh' e lules kur ze t'agojë,  
pranver'e bukur t'i skuq si mollë  
faqet e tua, buzët shebojë.

Ah rritu, rritu, moj gjeraqinë,  
shkollar' e vogël, pranver'e re,  
ti kaqë e bukur do mbushç shtëpinë,  
një tuf' me zoçka do kemi ne...

Ti rritu, rritu një mot çdo ditë,  
se po të presim me mall, o moj,  
dhe me ty bashkë do çel të ritë,  
jetës, moj flutur, do t'i këndoj!

## TE LUMTË, MOJ MOTER!

C'u rrit kaq me ditë kjo çup' e Vasilit,  
oh sa vojti i mjeri gjer la kokën shpatit;  
po ja sot e bija, konxhe trendafilit,  
na erdhi mësuese për fëmijët e fshatit.

Shihni, mor, pa shihni sa ësht' zbukuruar, —  
një çup' kaq e bukur derën të na zeri!  
Lum fëmijët tanë c'kan' për të mësuar,  
sa të ngrohtë syrin, gojën si sheqeri!

Të lumtë, moj motër, c'paske lulëzuar,  
kjo pranvera jonë sa të paska rritë!  
Ja, këtu yt atë ra duke luftuar, —  
sot ti po na kthehe që të japësh dritë!

## O MËSUES!

Këta nxënës, konxhe prillit,  
o mësues, të pastër rriti!  
Me mësimet, rreze diellit,  
me urti ti mendjet ndriti !  
Jepu krah' të fluturojnë,  
rritju zemrën, o vëlla,  
jepu zë të ligjërojnë,  
çelju sytë të vështrojnë  
ç'vepra ngrihen sot për ta!

## JU QOFTE UDHA E MBARE!

Shkoi dhe vit' i fundit, nxënësit më lanë,  
në shkollat e larta ata ikn' e shkuani,  
si zogjtë e fëllëzës ata m'u shpérndanë  
Si ditët e ëmbla ata fluturuan...

Pëllumba të paqes, ju qoftë udha e mbarë!  
Shihni, shokë, shihni ç'djell që po agon  
Djell, m'i puth në faqe fëmijët shkollarë,  
mësuesi, u thuaj, kurrë s'ju harron!

MAURITANIA ET ALGERIA

MAURITANIA ET ALGERIA

MAURITANIA ET ALGERIA

ME..... II. Bedol e lata eleti  
ME..... Hidrid eponiq'z dysh qe  
ME..... mësimdh  
ME..... edola M. zot  
ME..... mësimdh  
ME..... tuz,

## TRYEZA E LËNDËS

Faqe

## NË VEND TË PARATHËNIES

Erdhën dallandyshet .....	3
Një yll .....	4
Si ata .....	5
Varfëri e shkretë .....	6
Sot kam vatan .....	6
Dashuria e vërtetë .....	7
Lum ti, mësues! .....	8

## I. NË ZJARR E FLAKË

Ky prill sivjet .....	9
Olimbia, poemë .....	10
Lapidari .....	29

## II. NETËT PA HËNË

O nënë! .....	30
Kjo nuk ish përrallë .....	31
T'u harroftë emri .....	31
Ia ruaj zjarrë .....	32
Shiko tokën! .....	32

## III. KËNGA JOTE TË BUÇASE

Moj e bukura uzinë .....	34
Kënga zjen së largu .....	34
Rojes .....	35

## IV. KY ZJARR NË KRAHARUAR

Dale moj e folmë ti .....	36
Pa dëgjo ç'këndon bilbili .....	37
Frymëzim .....	37
Dëshirë .....	38
Sot të njoha .....	39
Endërrim .....	39
Asaj .....	40

Të më vish dhe tinë .....	40
Eja, flutur, eja! .....	41
Më thirrë shoqet .....	42
Dy axhaminj .....	43
Andej fshatit tonë .....	44
Shoqet më mbajnë mëri .....	45
Të të them .....	46
Elegji .....	46
Të zu djelli faqet .....	47

#### V. TE SHKOLLA MBI LENDINË

Festë për shkollën e re .....	48
Mirëmëngjez, o djell! .....	48
Te rrugic' e malit .....	49
Në klasë .....	49
Kursistat .....	50
Gëzimi im .....	51
Më ngjan një flutur .....	51
Të lumtë, moj motër!	52
Ju goftë udha e mbarë .....	53